



AKT THEMELUES

I SHOQERISE TREGETARE PRIVATE " MEDEA " sh.p.k

Une Pranvera Ulliri e bija e Ibrahimit dhe e Ferides, datl.1969, lindur e banuese ne Kruje. Mbeshtetur ne nenin 251, shkronja"ç",te Ligjit Nr.7512 date 10.08.1991" Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit", krijoj shoqerine tregtare private me pergjegjesi te kufizuar te quajtur " MEDEA "dhe me aktin themelues si vijon:

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur " MEDEA " sh.p.k. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortakut themelues.

VEND-QENDRIMI I SHOQERISE

NENI 2

Vend-qendrimi I shoqerise tregtare private " MEDEA " sh.p.k. do te jete ne Kruje. Shoqeria do te hap dhe vend-qendrimet e tjera te dyta, dege, filiale, perfaqesi dhe agjensi ne te gjitha territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratim te organeve kopetente dhe jashte vendit.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

- Import-eksport, tregetin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve me shumice e pakice.
- Punime druri, tregetime prodhimesh te ndryshme druri, mobilje, orendi, dyer, dritare etj.
- Punime druri me konstruksione metalike si mobilje zyresh, shkollash etj.
- Prodhim e tregetim inerte.
- Tregetim artikuj te ndryshem industriale.
- Tregetim artikuj te ndryshem ushqimore.

- Tregetim fruta-perime.
- Tregetim automjetesh te çdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjese kembimi per to.
- Tregetim makinerish te ndryshme e paisje industriale e bujqesore dhe venjen e tyre ne shfrytezim.

Tregetim paisje elektro-shtepiake, elektronike, kompjuterike, higjeno-sanitare, dhe hidraulike, prodhime qeramike e artizanati etj.

- Tregetimin e pllakave.
- Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit.
- Transport pasagjeresh brenda dhe jashte vendit.
- Tregetimin e materialeve te ndertimit e lendeve te para brenda dhe jashte vendit.
- Tregetim bimesh medicinale e etero-vajore.
- Tregetim pleherash e prodhime te tjera kimike.
- Tregetim prodhimesh kozmetike e estetike.
- Hapje dhe shfrytezim hotelesh, motelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi e kurative.
- Punime duralumini e tregetimi I tyre.

NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi prodhimi, perpunimi, sherbimi, e tregetimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pa caktuar dhe mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali I shoqerise tregetare private "MEDEA" sh.p.k.do jete 100.000 leke, dhe do te perbehet nga kuota e ortakut te shoqerise. Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te ortakut themelues. Kapitali eshte teresisht I shlyeshem dhe I nenshkrueshem.

NENI 7

Ortaku I vetem duhet te beje perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruaje sekretin e saj dhe te mos demtoje interesat e personave te tjere dhe te shoqerise.



DREJTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te drejtohet nga administratori I saj ortakut themelues I shoqerise znj. Pranvera Ulliri.

NENI 9

Te ardhurat neto te shoqerise I takojne ortakut themelues te shoqerise.

NENI 10

Ortakut themelues ka te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale te shoqerise. Ai ka te drejte te caktoje financier, likuidator per problemet e shoqerise, si dhe te pajtoje persona te tjere si ortatake Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare te tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.

NENI 11

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen dhe zgjidhen ne zbatim te legjislacionit shqiptar.

NENI 12

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakonshme, me tekstin per rrethin e saj.

NENI 13

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Mbi krijimin e shoqerive tregetare" .

NENI 14

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kopetente.

NENI 15

Akti I themelimit, u perpilua ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje do te mbetet dokumentacionin baze te shoqerise tregetare private "MEDEA " sh.p.k



Akti I themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

“ MEDEA “ sh.p.k
Pranvera ULLIRI

STATUT



SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "MEDEA"

Ne baze te Ligjit 7512 date 10.08.1991"Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private,nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit"dhe te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregetare", me vullnetin tim te lire, te shprehur ne nenshkrimin e Aktit Themelues:

Une Pranvera Ulliri e bija e Ibrahimit dhe Ferides, datl. 1969, lindur e banuese ne Kruje.

Hartoj statutin e shoqerise si me poshte:

EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

Shoqeria emertohet "MEDEA" sh.p.k.

NENI 2

Selia e shoqerise tregetare private "MEDEA" sh.p.k. do te jete ne Kruje.

NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti I regjistrimit ne regjistrin tregetar, prane Gjykates se rrethit Tirane.

NENI 4

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e:

- Import-eksport, tregetimin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve me shumice e pakice.
- Punime druri, tregetime prodhimesh te ndryshme druri, mobilje, orendi, dyer, dritare etj.
- Punime druri me konstruksione metalike si mobilje zyresh, shkollash etj.
- Prodhim e tregetim inerte.
- Tregetim artikuj te ndryshem industriale.
- Tregetim artikuj te ndryshem ushqimore.
- Tregetim fruta-perime.
- Tregetim automjetesh te çdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjese kembimi per to.

- Tregetim makinerish te ndryshme e paisje industriale e bujqesore dhe venjen e tyre ne shfrytezim.
- Tregetim paisje elektro-shtepiake, elektronike, kompjuterike, higjeno-sanitare, dhe hidraulike, prodhime qeramike e artizanati etj.
- Tregetimin e pllakave.
- Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit.
- Transport pasagjeresh brenda dhe jashte vendit.
- Tregetimin e materialeve te ndertimit e lendeve te para brenda dhe jashte vendit.
- Tregetim bimesh medicinale e etero-vajore.
- Tregetim pleherash e prodhime te tjera kimike.
- Tregetim prodhimesh kozmetike e estetike.
- Hapje dhe shfrytezim hotelesh, motelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi e kurative.
- Punime duralumini e tregetimi I tyre.

NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi prodhimi, perpunimi, sherbimi, e tregetimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali themeltar I shoqerise tregetare private " MEDEA " sh.p.k. do te jete 100.000 leke. Kapitali fillestar I shoqerise mund te ndryshohet sipas vendimit te ortakut themelues te shoqerise. Kapitali eshte teresisht I shlyeshem dhe I nenshkrueshem.

NENI 6

Kapitali I shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros, pasuri te lujtshme ose te pa lujtshme etj, te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 7

Kuota e kapitalit fillestar eshte dredhur nga ortaku themelues ne Banke, ne llogarine bankare te shoqerise, si edhe te regjistruara ne librin e llogarise te shoqerise.

NENI 8

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, I takojne ortakut themelues, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

NENI 9



Shoqëria tregëtare " MEDEA " sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, materiale ose jo-materiale, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurisë së vet tek të tjerët. Në Republikën e Shqipërisë, Shoqëria tregëtare " MEDEA " sh.p.k. gëzon të drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Shoqëria tregëtare " MEDEA " vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimit vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaku themelues i shoqërisë mbart rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në të.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISE

NENI 11

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, ortaku themelues i shoqërisë, znj. Pranvera Ulliri.

NENI 12

Hyjnë brenda detyrave dhe kompetencave të ortakut themelues si më poshtë:


1. Ndryshimi i aktit të themelimit dhe i statutit të shoqërisë.
2. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve të administrimit, i inventareve dhe bilancit e llogarive vjetore.
3. Zgjedhja e administratoreve jo-ortake dhe caktimi i detyrave dhe i kompetencave të tyre, me përjashtim të atyre që shënohen në statut.
4. Aprovimi i garancive që ka shoqëria.
5. Miratimi i tarifave për shërbimet që kryen shoqëria.
6. Pranimet në punë dhe largimet nga puna.
7. Caktimi i formës së vules dalluese të shoqërisë.
8. Kryerja e të gjitha veprimeve të administrimit të Shoqërisë në emer, për llogari dhe për interes të saj.

NENI 13

Administratori jo ortak përveç detyrave që i caktojnë ortakët e shoqërisë ka edhe këto detyra të tjera:

1. Të mirë-administrojë pasurinë e shoqërisë
2. Të bëjë marrveshje me të tretet brenda objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe

- kopetencave te caktuara nga ortaku themelues.
3. Te zbatoje rregulloren e brendeshme te shoqerise.
 4. Te pergjigjet per demet qe I sjell Shoqerise nga veprimet e tij.
 5. Te paguhet per punen qe kryen ne baze te merrveshjes se bere me ortakun themelues.
 6. Te marre te dhena dhe te beje propozime pergjithçka qe e çmon si te dobishme per shoqerine.
 7. Te kryere te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise.



TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

NENI 14

Shoqeria ka te drejte:

1. Te kryeje veprimtari ne baze te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimtarise.
2. Te siguroje pasurine e vet.
3. Te marre kredi ne leke dhe ne valute nga Bankat vendase dhe te huaja ne baze te rregullave ligjore.
4. Te perfitoje nga favoret qe I njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera.
5. Te investoje kudo ne Shqiperi, nga te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj.
6. Te punesoje punetore te thjeshte ose te kualifikuar, vendas ose te huaj.
7. Te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj.

NENI 15

Shoqeria ka per detyre:

1. Te siguroje kapitalin themeltar ne formen dhe kohen e duhur.
2. Te jape garanci per sherbimet qe kryen shoqeria.
3. Te siguroje punonjesit e saj.
4. Te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo.
5. Te respektoje standartet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarine e saj.

MARRDHENJET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

NENI 16

E gjithë veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

NENI 17

Ne seline e shoqerise mbahet dokumantacioni financiar, ne baze te te cilit, brenda dates 31 Mars te çdo viti nxirret bilanci.

NENI 18

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.



NENI 19

Shoqeria mban xhiro-llogarite ne Banke. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat perkatese.

NENI 20

Nga fitimet e realizuara gjate vitit financiar, shoqeria, pasi ben zbritjen e humbjeve te vitit te meparshem, le menjane 5% te fitimit, me te cilin krijohet fondi "Rezerve e domosdoshme", derisa ky fond te arrije masen 10% te kapitalit themeltar.

NENI 21

Te ardhurat neto, pas veçimit te fondeve te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, I mbesin ne perdorim ortakut themelues te shoqerise. Konvertimi I parase te realizuar nga shitja do te behet sipas kushteve qe do te kete Banka e shtetit Shqiptar, ose Bankat e tjera private dhe transferimi I saj do te behet ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise.

DISPOZITA TE VECANTA

NENI 22

Shoqeria ka vulen e vet dalluese.

SHNDERRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

NENI 23

Shnderrimi I shoqerise " MEDEA " sh.p.k. ne shoqeri te tipeve te tjera, kolektive ose me drejtim te thjeshte, mund te behet me vendim te ortakut themelues.

NENI 24

Shperberja e shoqerise, mund te vije ne cdo kohe dhe per çfar do shkakut si :

- Humbja e kapitalit te shoqerise,
- Pamundesi veprimi,
- Me vendim te asamblese te ortakeve

Ne keto raste, pronari I shoqerise vendos mbi menyren e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke ju percaktuar dhe detyrat

Administratori dhe likuidatori jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise perderi sa ajo t'u dorezohet personave perkates fizike e juridike, duke u likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria.

Ne rast se fondet disponibel, rezultojene te pa mjaftueshme, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likuidatori mund t'i kerkoje ortakut themelues te shoqerise qe te derdhe te persisht kuotat qe I takojne atij



DISPOZITA TE PERGJITHESHME

NENI 25

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, referohen plotesimet qe do te behen nga ortakut themelues, si edhe ligjeve te veçanta te legjislacionit shqiptar. Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen ne menyren dhe proceduren me te cilen nxirret vete statuti.

NENI 26

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregtare private " MEDEA " sh.p.k.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

" MEDEA " sh.p.k.

Pranvera ULLIRI